



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:225083
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05776441

Kom.Dh.Shk.II.nr.180/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Nëna Terezë”, p.nr., kundër debitorëve 1. N.H., me adresë në fshatin Shipol, Komuna e Mitrovicës, huamarrëse dhe pengëlënëse, 2. Baki Sh.P.K., me adresë në rr. Vlora, Komuna e Mitrovicës, e përfaqëson N.H. huamarrëse dhe pengëlënëse, e përfaqësuar me autorizimi Agron Krasniqi avokat nga Prishtina, sipas dokumentit të besueshëm përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2114/22 të datës 29.09.2023, me datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve 1. N.H., me adresë në fshatin Shipol, Komuna e Mitrovicës dhe 2. Baki Sh.P.K., me adresë në rr. Vlora, Komuna e Mitrovicës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2114/22 të datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.2114/22 të datës 29.09.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorëve 1. N.H., me adresë në fshatin Shipol, Komuna e Mitrovicës dhe 2. Baki Sh.P.K., me adresë në

rr. Vlora, Komuna e Mitrovicës, i ushtruar kundër urdhëri përmbarimor P.nr.713/2022 të datës 09.06.2022, të përmbaruesit privat Atip Mustafa, me seli në Vushtri, në pikën II ka mbetur në fuqi urdhëri përmbarimor P.nr.713/2022 të datës 09.06.2022, të përmbaruesit privat Atip Mustafa, me seli në Vushtri.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitorët për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe kanë cekur se urdhëri përmbarimor është bërë në bazë të dokumenteve përmbarimore që kjo kontratë nuk mundë të ket tipare të përmbarimit siç parasheh dispozita e LPP-së, prandaj kanë propozuar që pranohet prapësimi dhe të anulohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2114/22 të datës 29.09.2023 dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit, duke kundërshtuar pretendimet e debitorëve në ankesë dha ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pa themeltë, të mbetet në fuqi aktvendimi i atakuar KPPP.nr.2114/22 të datës 29.09.2023 dhe të vazhdohet procedura përmbarimore sipas propozimit të përmbarimit.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 04.10.2016, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të përmbarimorë – Kontratës mbi Pengun për sigurimin e kërkesave nga Kontrata mbi lejimin dhe lëshimin në shfrytëzim të krediti kartelave bankare për individ (Visa Classic, Visa Gold apo Master Card) nr.277675 e datës 07.12.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20201208-29 të datës 08.12.2020 me përfundim deri me datën 31.12.2025, të paguaj për shumën e borxhit prej

275.88€, nën kërcënimin të përmbarrimit me dhunë, përfshirë shpenzimet të procedurës e përmbarrimit.

Përmbarruesit privat Atip Mustafa, me seli në Vushtrri, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm– Kontratës mbi Pengun për sigurimin e kërkesave nga Kontrata mbi lejimin dhe lëshimin në shfrytëzim të krediti kartelave bankare për individ (Visa Classic, Visa Gold apo Master Card) nr.277675 e datës 07.12.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20201208-29 të datës 08.12.2020 me përfundim deri me datën 31.12.2025, të cilat janë kopje të vërtetuara tek noteri, të cilat paraqesin dokumente përmbarruese në bazë të nenit 22 par.1.7 të LPP-së.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarrimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se duhet anuluar urdhëri përmbarrimor pasi që, dokumente bazë në të cilat është filluar përmbarrimi nuk mundë të iniciohet procedura përmbarrimore në bazë të nenin 21 të Ligjit për regjistrimin e pengut për sendet e luajtshme dhe se procedura përmbarrimore duhet të iniciohet në bazë të ligjit për procedurën përmbarrimore. Andaj ka propozuar që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përmbarrimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar me asnjë prove dhe dokumentet në bazë të së cilës ka filluar procedura përmbarrimore është lejuar me bazë të kontratës së pengut e cila parashihet si titull ekzekutiv në nenin 5 të Ligjit nr.05/L-118 dhe palët sipas kontratës së pengut jan pajtuar kushtet dhe obligimet që dalin nga kjo marrëveshje, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhëri përmbarrimor.

Lidhur me prapësimin, Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.2114/22 të datës 29.09.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorëve 1. N.H., me adresë në fshatin Shipol, Komuna e Mitrovicës dhe 2. Baki Sh.P.K., me adresë në rr. Vlora, Komuna e Mitrovicës, i ushtruar kundër urdhëri përmbarrimor P.nr.713/2022 të datës 09.06.2022, të përmbarruesit privat Atip Mustafa, me seli në Vushtrri, në pikën II ka mbetur në fuqi urdhëri përmbarrimor P.nr.713/2022 të datës 09.06.2022, të përmbarruesit privat Atip Mustafa, me seli në Vushtrri.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë të pa qëndrueshëm, sepse këtë dokumente i plotësojnë kushtet ligjore në kuptim të nenit 21, 22, dhe 27 të LPP-së. Pra sipas nenit 21 të LPP-së përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa sipas nenit 22 në para. 1.7 përcakton se dokumente përmbartues *“kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent the regjistruar ne regjistrin publik sipas ligjit”* ndërsa ne nënpara. 1.7a ka parapare se dokument përmbartimore është edhe *“kontrata për pengun e regjistruar ne regjistrin zyrtar te pengut”*. Gjithashtu sipas nenit 27 të LPP-së përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga këto dispozita rrjedhe se, përmbartimi mund te fillohet ne baze te kontratës për hipotekën, nëse kjo e fundit është vërtetuar nga organi kompetent dhe e hipoteka është e regjistruar ne regjistrimin publik. Ne rastin konkret gjykata gjen se janë plotësuar te gjitha këto kushtet te kërkuara me LPP, pasi kontrata është e lidhur ne forme aktit noterial dhe është regjistruar ne regjistrin e te drejtave mbi pronën e paluajtshme. Gjithashtu, sipas dispozitave te cituara me larte, përmbartimi mund te fillohet edhe ne baze te kontratës për pengun, nëse pengu është i regjistruar ne regjistrin zyrtar për pengun. Gjykata gjen se edhe pengu është i regjistruar në regjistrin e pengut. Andaj, meqenëse hipoteka dhe pengu i plotësojnë te gjitha kushtet e parapara me LPP, atëherë gjykata drejt ka konstatuar se kontratat e cekura më larte për pengun dhe hipotekën i plotësojnë te gjitha kushtet për përmbartueshmëri. Rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit të përmbartimit të përcaktuar me nenin 73 par 1 të LPP-së.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës se Gjykata e shkallës së par drejt ka vendosur se pretendimet e debitorit janë të pa qëndrueshme pasi që, me ne shkresat e lendes gjendet kontratat e lartcekura për hipotekën dhe pengun janë në kopje të vërtetuar te noteri. Gjykata e sheh te rëndësishme te sqaroj se, sipas nenit 36 para. 1 dhe 38 para. 1 te LPP-s vetëm dokumentet përmbartimore duhet te dorëzohet ne origjinal ose ne kopje te vërtetuar, ne këtë rast

kontratat e cekura më larte për pengun dhe hipotekën, por jo edhe dokumentet tjera, siç është kontrata e cila sigurohen me peng ose hipoteke ose vërtetimet mbi regjistrimin e këtyre te drejtave. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar, i ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.713/2022 të datës 09.06.2022 dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbartimor P.nr.713/2022 të datës 09.06.2022, të përmbartuesit privat Atip Mustafa, me seli në Vushtrri.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.180/24, me datë 04.06.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti